



Prishtinë: 18.09.2008

Kodi i ZRRE-së: V_119_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_90_06_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK në ZRRE;
5. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_90_06_08 të datës 12.06.2008;
6. Parashtrimin e kundërshtimit të vendimit të DMK nga ana e konsumatorit, drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 26.06.2008
7. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 18 shtator 2008 nxori këtë:

VENDIM

REFUZHET apelimi i konsumatorit Latif Hasani, (shifra e konsumatorit DPR – 271283) nga Prishtina, kundër Vendimit të DMK për arsye të paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi

Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK në ZRRE me datë 11.05.2007 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit – Departamentit për Konsumatorë me numër reference DPR – COI 1 – 06 lidhur me kalkulimin e gjobës për shfrytëzim të paautorizuar.
2. Me datë 26.02.2007 ekipi i autorizuar i KEK Sh.A – Departamenti i humbjeve Komerciale gjatë kontrollimit të instalimit elektrik të pronarit kanë gjetur te pala urat e larguar tek njehsori elektrik dhe për këtë rast ka përpiluar procesverbalin nr. 0.12543.
Provë: Procesverbali nr. 12543 i datës 26.02.2007
3. Me datë 20.03.2007 KEK Sh.A – Njësia e rrjetit në Prishtinë e ngarkon konsumatorin për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike me anë të faturës DPR07HP02574 në shumë prej 4,198.83 €.
Provë: Fatura DPR07HP02574 e datës 20.03.2007
4. Me datë 17.04.2007 konsumatori parashtron ankesë KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit – Departamentit për Konsumatorë lidhur me ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.
Provë: Ankesa dhe dëftesa e konsumatorit



5. Me datë 10.05.2007 KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamentit për Konsumatorë i përgjigjet konsumatori duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në rregulloren interne për caktimin e harxhimit të paautorizuar, rregullave të miratuara nga ZRRE dhe në bazë të procesit të ekipit të kontrollës si dhe faturës së lëshuar nga divizioni i furnizimit.
Provë: Përgjigja e KEK Sh.A me numër të referencës DPR – CO1 – 06
6. Me datë 11.05.2007 konsumatori ka apeluar në DMK të ZRRE-së përgjigjen e KEK-ut me numër reference DPR – CO1 – 06 të datës 10.05.2007.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
7. Me datë 12.06.2008 DMK ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga KEK Sh.A dhe konsumatori dhe ka vendosur ta refuzojë konsumatorin.
Provë: Vendimi i DMK-së në ZRRE i datës 12.06.2008
8. Me datë 26.06.2008 konsumatori ka parashtruar kundërshtimin e tij kundër vendimit të DMK-së në Bordin e ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_90_06_08** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar